

VENDIM
Nr. 174, datë 7.11.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “AXPO ALBANIA” SHA NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pika 1, 3 dhe 4 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr.101/7 prot., datë 31.10.2019, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “AXPO ALBANIA” sh.a., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

konstatoi se:

- Shoqëria “AXPO ALBANIA” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 459/1 prot., datë 22.10.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Kjo shoqëri është regjistruar pranë QKB-së, në datën 22.4.2005, me statusin e shoqërisë aksionare (sh.a.), konform legjislacionit në fuqi dhe mban numër identifikimi (NUIS) K51628010V. Kapitali themeltar i kësaj shoqërie, zotërohet nga aksionari “AXPO Solutions AG”, në masën 100%.

- Objekt i veprimtarisë së saj është: Zhvillimi i projektit të sistemit të gazsjellësit natyral, të quajtur Trans Adriatik Pipeline–TAP (Linja e tubacioneve trans adriatike), i cili do të fillojë me aplikimin për koncesion për të realizuar ndërtimin e TAP-it në fund të vitit 2008. Zhvillimin e projektit të Terminalit të Regazifikimit të LNG (Gazit natyral të lëngët) në bregdetin Shqiptar, si një pjesë integrale e projektit TAP. Zhvillimin e projektit të Stokimit Nëntokësor të Gazit si pjesë integrale e projektit TAP. Aktivitet e marketingut për kontraktimin me konsumatorët kryesore të gazit të kontratave të furnizimit për periudhën 2008–2023. Aktivitet marketingu për kontraktimin e importit dhe eksportit të energjisë elektrike me konsumatorë të zgjedhur, duke përfshirë edhe plotësimin e aplikacioneve për furnizimin me energji elektrike te konsumatorët e zgjedhur në shoqëri dhe në KESHI-in. Aktivitete sipërmarrjeje, tregtinë e energjisë, import-eksportin dhe shpërndarjen e energjisë, aktivitetet tregtare dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me aktivitetet e lartpërmendura në një kuptim të gjerë.

- Aplikimi i shoqërisë “AXPO ALBANIA” sh.a., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE-ja në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat: “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d” “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar pjesërisht;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht;
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, (neni 9, pika 4.8, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht.

Në lidhje me mungesën apo plotësimin e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor. Neni 9, pika 2, germa “e” (struktura e ndërtimit të shoqërisë, lista e personelit sipas profilit, në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca).

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal. Neni 9, pika 3, germa “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore):

germa “b” (bilanci financiar për vitet 2016 dhe 2017);

germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit).

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Neni 9, pika 4.8:

germa “b” (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti). Shoqëria nuk ka bërë me dije në ERE se cilën pjesë të kapitalit vë në dispozicion të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike dhe nuk ka depozituar dokumentacion provues në lidhje me këtë shumë;

germa “c” (lista e kontratave të mëparshme, nëse ka pasur). Shoqëria deklaron se kontratat i realizon me bazë mujore me shoqëritë simotra AXPO Belgrade, Axpo Romania për të cilat lehtëson hyrjen në tregun shqiptar dhe tranzit por nuk ka depozituar kopje të këtyre kontratave.

Do të njoftohet aplikuesi që në bazë të nenit 10, pika 9 dhe nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “AXPO ALBANIA” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike nga marrja dijeni, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti